



Konferenca mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Njësive Ekonomike Familjare 2014 17 September 2015

Fjala e zv. Kreut të Misionit, Ambasada Zvicerane, z. Philipp Keller

I dashur Drejtor i INSTAT-it, z. Filipi, të dashur përfaqësues të institucioneve qeveritare, të dashur miq e partnerë,

Jam i kënaqur që kam rastin të mbaj një fjalë hapëse sot në Konferencën mbi Statistikat Rajonale dhe Buxhetin e Njësive Ekonomike Familjare 2014.

Që kur censusi i parë në Shqipëri u krye në vitin 2001, Zvicra ka mbështetur Institutin Kombëtar të Statistikave (INSTAT) në përpjekjet për të zhvilluar dhe prodhuar informacion cilësor statistikor. Asistenca jonë në vitet e fundit është fokusuar në Census 2011 dhe veçanërisht në analizën dhe aktivitetet post-Census.

Si pjesë e mbështetjes sonë më të fundit për INSTAT, Zvicra me asiston për adaptimin e portalit GIS në web për vizualizimin e të dhënave sipas ndarjes së re territoriale dhe administrative, duke ndërtuar një aplikacion celularësh për të diseminuar dhe komunikuar statistikën tek një audiencë më e gjerë, dhe për të publikuar Librin e Statistikave RAjonale.

Libri i Statistikave Rajonale, publikimi i të cilit është tema e konferencës së sotme, përmban një pasuri me treguesit më të fundit social dhe ekonomikë të ndarë sipas rajoneve në Shqipëri. Ky informacion dhe të dhënat do të jenë veçanërisht të rëndësishme për formulimin e strategjive rajonale dhe planifikimin në kontekstin e decentralizimit institucional, dhe për të synuar asistencën sociale dhe lloje të tjera të ndërhyrjeve shtetërore. Kështu ky publikim vjen në kohën e duhur për zbatimin e reformës decentralizuese në vazhdim e cila është thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të vendit dhe që Zvicra po e mbështet përmes projekteve të tjera. Besoj se ky publikim do të jetë i aksesueshëm në formate të ndryshme dhe të përdoret nga shumë grupe interesi në vend, duke filluar nga vendim-marrësit dhe duke vazhduar me kërkuesit, akademikët, shoqëria civile dhe media.

Do të doja të jepja urimet më të sinqerta për INSTAT që udhëheq këtë punë të rëndësishme dhe ti uroj sukses në rolin domethënës që ka për zhvillimin e vendit.

Falemnderit!